

DE 992/2025



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Driton Hoxha" nr. 55, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 500 400, Fax: +383 (0)38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

Bazuar në Nenin 47, paragrafin 10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Rregulloren (QRK) NR 05/2024 për ndryshim dhe plotësim të Rregullores 15/2023 dhe Vendimin me numër A.nr. 682/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e më poshtëm KPMSHCK) të datës 17.06.2025, pranuar në AKP me datë 26.06.2025 me Nr. Protokolli 3095, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 30 Qershor 2025, publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 27 Janar 2025, ka shpallur konkursin me nr. reference RN00016511 për pozitën DREJTOR EKZEKUTIV në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, kandidati, i pakënaqur me procesin e rekrutimit nr. ref.: RN00016511, ka parashtruar ankesë në KPMSHCK.

KPMSHCK, me Vendimin A.nr. 682/2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi dhe obligon AKP-në të "Anuloj në tërësi procedurën e rekrutimit të shpallur sipas konkursit me nr. ref. RN00016511", dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit njofton për anulimin e procedurës së rekrutimit me nr. ref. RN00016511.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 30 Qershor 2025



Fatos Meqa

Udhëheqës i Burimeve Njerëzore

Agjencia Kosovare e Privatizimit